



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.550/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi- Referues dhe Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Berisha Com” sh.p.k - Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Konzorciumi “NPSH Eltoni COM & Bejta Commerce SHA & Eurocom SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovës, me datën: 25.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Berisha Com” sh.p.k -Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovës.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovës dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Berisha Com” sh.p.k - Gjakovë aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik “Berisha Com” sh.p.k - Gjakovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.08.2020 me nr. 550/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Konzorciumi “Bejta Commerce SHA, NPSH Eltoni COM, Eurocom SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje ndërtimi-ilegale dhe shërbime tjera” me nr. të prokurimit: 632-20-1610-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 2, 7, 24.2, 51, 56, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.08.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt. 31.08.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit Autoriteti Kontraktues në këtë rast Komuna e Gjakovës, ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht neneve të lartë cekura. Duke devijuar nga kriteret e përzgjedhjes të vendosura në Dosjen e Tenderit.

Me rastin e rekomandimit për dhënie të kontratës, është shkelur rëndë Lpp-ja me nr.04/L-042, e plotësuar dhe ndryshuar me Lpp nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-92. Duke shkelur Nenin 1,2,7,24, Neni 51,56 Neni 59, Neni 60.

Dokumentet të cilat i mungojnë konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A; N.P.SH. ”Eltoni Com”; “Eurocom” Sh.p.k. janë:

Kompanija COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A është caktuar si lider I grupit, mirpo me lidhjen e ofertes shohim qe lider ne paraqitjen e dosjes së tenderit është kompanija N.P.SH. "Eltoni Com".

Deklaratat Nën Betim të paraqitur në dosjen e tenderit nuk janë të marrura nga dosja e tenderit, ju mungon titulli I projektit si dhe nr I prokurimit.

Inxhinierat si Izajdin Sylaj Gjeodeti, është Gjeodet te cilit I ka skaduar Liçensa. Inxh Muhamet Selimi e ka dipolomen te pa verifikueshme nuk lexohet.

Ju mungojnë kontratat e puntorëve siç është kërkuar në FDT nga AK Komuna e Gjakovë.

Ky koncerzium ka munges edhe tek makineritë si:

- 1 Lug Ngarkues Mungon.
- Rimorkio me targa 06-165-AX nuk ka regjistrim
- Rimorkio me targa 06-178-XB nuk ka regjistrim
- Rimorkio me targa 06-408-XB e kalon peshen e kërkuar ne Dosjen e Tenderit

Të gjitha këto konstatime dhe prova vertetetojnë se koncerziumi i rekomanduar për dhënie te kontrates COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A & N.P.SH. "Eltoni Com"&"Eurocom" Sh.p.k. nuk është i pergjegjshem.

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik BERISHA COM SH.P.K e dt. 26.07.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera", me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK -së, të datës 28.05.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 28.05.2020;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik BERISHA COM SH.P.K, me datë 26.07.2020,ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve te ngritura pa leje ndërtimi-Ilegale dhe shërbime tjera", me Nr. të Prok: 632-20-1610-5-2-1,.

Eksperti Shqyrtues sqaron se AK nuk i përgjigjet OE ankuesit lidhur me pretendimet në kërkesën për

rishqyrtim shih mëposhtë:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupi Operatorëve Ekonomik "Company Bejta" SH.A. & N.P.SH."Eltoni Com" & "Eurocom" sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Eksperti Shqyrtues gjithashtu sqaron se lidhur me këto pretendime të OE ankuesit fillimisht është marrë një vendim me datën 09.07.2020 PSH me nr. 370/20, ku lënda është dërguar në rivlerësim.

Citat PSH nr 370/20: *"Paneli Shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlersimi dhe krahasimi i tënderve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkosisht nuk është rrespektuar edhe neni 60 I LPP-së kriter kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlersimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitat të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë"*

Eksperti Shqyrtues konsideron se AK gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka bërë vlerësimin efikas konform LPP-së dhe Rruopp-së, ku AK gjatë këtij procesi është dashur që të verifikoj dhe vlerësoj po ashtu edhe këto pretendime, psh po i përmendim disa nga më të rëndësishmet:

- Deklarata nën betim nuk është shkarkuar nga e njejta DT, AK është dashur që në procesin e vlerësimit të kërkojë sqarim (shih tek faktet e rendesishme në shembujt sesi të veprohet në Rruopp) dhe po ashtu të jap sqarim në kërkesën për rishqyrtim.
- Kontratat e Punëtorve të OE të rekomanduarit mungojnë, këtë pretendim ne e kemi gjetur të bazuar, andaj AK është dashur të verifikoj dhe vlerësoj dhe të veproj konform nenit 72 të LPP-së.
- Lidhja e Konzorciumit në ofertë dhe procesverbalin e hapjes së tenderit dhe në kontratat e konzorciumit janë të ndryshme, edhe për këtë pretendim është dashur AK të jep sqarime ose nëse ka qenë skeptik e cila nuk ka interpretim të qartë në LPP, atëherë ka mundur të kërkojë sqarim edhe në KRPP. etj.

Eksperti Shqyrtues sqaron se OE ankuesi ka paraqitur po ashtu edhe disa pretendime për konzorciumin tjetër: N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k & Company Zuka Commerce Sh.p.k, koncerzium i përgjegjshëm nga AK Komuna e Gjakovës po i pa suksesshëm.

Me qasjen tonë kemi vrejtur se edhe ky konzorcium nuk është i përgjegjshëm, dokumentet që i mungojnë

këtij koncerziumi janë...

Eksperti Shqyrtues sa i përket pretendimeve të OE ankuesit rreth këtij konzorciumi, nuk i sheh të arsyeshme që ti shqyrtojë, me faktin se ky konzorcium veçse është i eliminuar prap nga AK.

B42 - Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar⁴

23.07.2020 Gjakovë

Komuna e Gjakovës, Nëna Terezë pn. Gjakovë

Për: Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.Sh., Marash - Shped Sh.p.k; Company Zuka Commerce Sh.p.k. Sadik Stavileci, 50000, Gjakove

Nr. i Prokurimit:	632	2	0	0	1	4	5	2	1
-------------------	-----	---	---	---	---	---	---	---	---

Nga çka u cek më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet prapë në rivlerësim dhe se këto pretendime të OE ankuesit veç se janë të shqyrtuara, dhe OSHP ka nxjerr një vendim me datë 09.07.2020 P.SH. 370/20.

Andaj, AK në vazhdim është i obliguar që këtë proces të rivlerësimit ta vlerësojë dhe ekzaminoj në mënyrë të detajuar duke mos i shkelur dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rruopp-së.

AK gjithashtu sugjerohet që nëse ka paqartësi rreth ekzaminimit dhe vlerësimit, ta konsultojë KRPP-në në mënyrë që të jetë sa më transparent dhe objektiv.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankuesit "Berisha COM" SHPK të aprovohet, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe ky Aktivitet i Prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datën 02.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 07.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Berisha Com” sh.p.k – Gjakovë se gjatë qasjes në dokumentet e konzorciumit të rekomanduar për dhënie të kontratës “Company Bejta Commerce Sh.A”; N.P.SH. “Eltoni Com”; “Eurocom” Sh.p.k., ku Company Bejta Commerce Sh.A. është caktuar si lider i grupit, mirëpo me lidhjen e ofertës e shohim që lider në paraqitjen e dosjes së tenderit është kompania N.P.SH. “Eltoni Com” dhe deklaratat nën betim të paraqitur në dosje të tenderit nuk janë marrë nga dosja e tenderit, ju mungon titulli i projektit si dhe numri i projektit.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se OE Eltoni me datë 15.07.2020 i është drejtuar KRPP-së për interpretim me titull “Kërkesë për interpretim të lidhur me Aneksin 2-Deklarata nën Betim dhe Marrëveshjen e Konzorciumit”. Kurse, me datë 29.07.2020 KRPP-ja i kthen përgjigje duke dhënë sqarime lidhur me par. 4 të nenit 59 të LPP-së, 47.19 dhe 47.21 të RRUOPP-së, Konkretisht, KRRP-ja i jep këtë sqarim anëtarit të konsorciumit: “edhe pse për KRPP-ën një gabim i tillë do të konsiderohej devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale të dosjes së tenderit, megjithatë sipas paragrafit të lartë cituar Autoriteti Kontraktues duhet të vendos vet se çështja në fjalë a mund të konsiderohet si devijim i vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, Pra ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Berisha Com” sh.p.k – Gjakovë se gjeodetit Izajdin Sylja i ka skaduar licenca, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK duhet që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së që të konfirmoj nëse i njëjti ka licence valide. Sa i përket pretendimit se OE të rekomanduar i mungojnë kontratat e punëtorëve siç është kërkuar në FDT nga AK, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar dhe se AK duhet të kërkoj sqarime nëse i njëjti posedon këto kontrata konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Kurse, sa i përket pretendimeve të OE ankues “Berisha Com” sh.p.k – Gjakovë që kanë të bëjnë me konsorciumin tjetër N.T.SH.Marash-Shped Sh.p.k & Company Zuka Commerce Sh.p.k, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky konzorcium nuk është i përgjegjshëm dhe këto pretendime nuk janë shqyrtuar për faktin se ky konzorcium veçse është i eliminuar nga AK.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK me rastin e ekzaminimit të tenderëve nuk ka bërë vlerësimin sipas kërkesave të dosjes së

tenderit dhe njoftimit për kontratë, njëherit nuk ka bërë vlerësimin e ofertave në pajtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë nga operatorët ekonomik dhe të bëjë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna e Gjakovës

1x1 OE "Berisha Com" sh.pk- Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.